

**From:** av.Genci Ismaili [avgenci@gmail.com](mailto:avgenci@gmail.com)

**Sent:** Wednesday, May 8, 2019 11:35 AM

**To:** Keshilli 1

**Subject:** Mbi vazhdimesine e procesit te Kandidimit per ILD

Une Genci Ismaili, Avokat i Dhomes se Avokatise Tirane. pasi u njoha me kriteret e pershkruara per Kandidatet per ILD, nisur edhe nga fakti se gjithe kohën kam qene i angazhuar dhe i vetepunesaur, si Avokat, ne Dhomen e avokatise Tirane, i regjistruar ne organet Tatimore sipas ligjit. Kam paraqitur dokumentat ne KED qe logjikisht edhe ligji i Kerkon. Nuk kam qene asnjehere subjekt i Deklarimit te formularit te ILDKPI dhe ne kushtet kur ligji me ka perjashtuar nga ky kriter, nuk kam paraqitur edhe Deklaraten e ILDKPI ne KED.

Por nga ana e Keshillit Te Emerimeve ne Drejtesi eshte marre nje Vendim nr.4 date 11.03.2019, "Per proceduren e verifikimit te kandidateve qe konkurojne ne Gjykatën Kushteuese dhe ILD", i cili ne menyre selektive barazon subjektet e konkurimit qe i nenshtrohen Deklarimit te pasurise, me subjektet private ne Republiken e Shqiperise, ashtu si edhe ne fushen e avokartise etj.

Me kete menyre trajtimi joproporcional, dhe selektiv, konkurentet nga radhet e Avokatise, dublohen me artifica Deklaratash te ILDKPI, nderkohe qe jane subjekte te veprimtarise private. Si te tille verifikimi i tyre behet nga organet Tatimore, sipas ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Nisur edhe sa me lart, por edhe per nje proces kandidimi jo proporcional, dukshem selektiv per te kontrolluar kandidatet, me artifica te pabazuara ligjerisht dhe logjikisht, per keto lloj kriteresh, nuk krijoj bindjen per ecurine e nje gare konkurimi te besueshme. Per sa me lart;

**KERKOJ**

1-HEQJEN DORE NGA KANDIDIMI PER INSPEKTOR I LARTE I DREJTESISË (ILD).

2-Kthimin e dokumentave te depozituara prej meje ne Sekretarine e KED.

Konkurenti per ILD

Genci ISMAILI